



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.854/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore, Anita Peci duke vendosur përkitazi me apelin e Festim Avdyilit, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Prizren, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si i pa rregullt apeli i Festim Avdyilit, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Prizren, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

Me datën 10.11.2017, PZAP-i ka pranuar një apel nga Festim Avdyilit, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Prizren, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me të cilën thekson se në vendvotimet 2035A, 2026A/01R, 2062A/02D, 2020A/01R, 2020A/03D, i mungojnë votat, prandaj ka kërkuar rinumërimin e tyre.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të rregullsisë së apelit, gjeti se:

Apeli është i pa rregullt

PZAP-i, nga shkresat e lëndës vlerësoj se apeli i parashtruar nga Festim Avdyli kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Prizren, nga subjekti politik LDK është i parregullt, pasi që nuk është e nënshkruar nga parashtruesi i apelit dhe si i tillë apeli nuk i plotësonë kriteret e Rregullës Nr.02/2015 të nenit 5.6, ku përcaktohet se: Ankesat duhet të dorëzohen me shkrim dhe duhet të jenë të nënshkruara nga ankuesi apo në emër të tij nga i autorizuari.

Prandaj PZAP-i, nuk u lëshua fare në parashtrimet e apelit, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozitat e lartëtheksuara.

Nga arsyet e sipërshënuara e në mbështetje të nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr.854/2017 më datën 12.11.2017.

Kryesuesi i Panelit
Zyheir Haziri



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.